






Bundesamt
für Migration
und Flüchtlinge

Informacione për procedurën e azilit

Të drejta dhe detyrimet tuaja

ALBANISCH






Ju jeni në Gjermani për të parashtruar kërkesë azili.

Ne ju informojmë se si rrjedhon procedura e azilit në Gjermani dhe cilat të drejta dhe obligime i keni Ju.

Por Ju keni gjithashtu edhe për obligim të bashkëndikoni në mënyrë aktive përgjat tërë procedures dhe njehërit të thoni gjithnjë të vërtetën. Kjo është e rëndësishme për Ju, sepse përndryshe do të rrezikoni proceduren tuaj të azilit.



1 Mbërritja & regjistrimi



Përgjat arritjes suaj në Gjermani ju së pari do të regjistroheni. Ne përgjat asaj ju pyesim në lidhje me emrin tuaj, vendin e origjinës, datëlindjen, fenë tuaj, gjuhën dhe përkatësin etnike. Ne ju fotografojmë dhe njëherit ju marrim edhe gjurmët e gishtave. Fëmijëve nën moshën 6 vjeçare nuk ju mirren gjurmët e gishtave. Pas regjistrimit tuaj, Ju do të pranoni nga ne një dëshmi të mbërritjes dhe njëherit e parashtroni drejtëpërsëdrejti në qendrën e mbërritjes kërkesën tuaj për azil. Megjithatë është e mundshme, që ju së pari të vendoseni në një qendër strehimi azilkërkuesish. Atje ju do të merrni dëshminë e mbërritjes dhe do të informoheni se kur mund të paraqisni kërkesën për azil personalisht.




2 Shtrimi personal i kërkesës



Në terminin e parashtrimit të kërkesës suaj personale ju lutemi të sillni me vete "Ankunftsnaehweis" dhe të gjitha dokumentet dhe dokumentacionet tjera të rëndësishme, të cilat edhe i posedoni. Ato mund të jenë çertifikata juaj e lindjes ose pasaporta juaj; por gjithashtu edhe dokumentacionet e udhëtimit ose provat për arsyet e ikjes suaj, si për shembull fotografit. Ne ju pyesim juve për shenimet tuaja personale si dhe në lidhje me vendbanimin tuaj, mbi edukimin shkollor dhe trajnimin për profesion pune, njohurit e gjuhës dhe rrugën tuaj të udhëtimit.

Na informoni ne, se a janë veqse ka qendrojnë në Gjermani anëtar të familjes suaj, se ku banojnë ato dhe a gjinden apo a kanë qenë edhe ato në një procedurë azili. Pasi që të keni parashtruar kërkesën tuaj të azilit, ju për kohëzgjatjen e procedurës së azilit do të pranoni një të ashtuquajtur leje të qëndrimit-dokumenti juaj legjitimues. Ju lutemi mbani të njëjtin gjithnjë me vete.



3 Procedura- Dublin



Por para se të filloj procedura juaj, ne duhet të konstatojmë, se a është shteti i Gjermanisë apo ndonjë shtetë tjetër evropian përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës tuaj për azil. Një e tillë quhet procedura e Dublin-it. Ju nuk mund të vendosni vetvetiu se cili shtetë do të bëjë shqyrtimin e kërkesës suaj për azil. Për atë arsye ne ndër të tjera duhet të sqarojmë gjithashtu edhe faktin, se kur dhe ku keni hyrë brenda zonës së BE-së, se a keni anëtar tjerë të familjes tuaj në shtetet tjera anëtare të BE-së, ose a keni parashtruar një kërkesë të azilit në njërin prej shteteve tjera anëtare të BE-së. Ju e keni të drejtë të përmendni arsyet e duhura, se pse Ju nuk mund të ktheheni më në atë shtetë.

Nëse zyra federale vendosë, që një tjetër shtetë është përgjegjës për Ju, atëher Ju jeni i detyruar të ktheheni prapë në atë shtetë, në mënyrë që kërkesa juaj të mund shqyrtohet atje. Ju ndaj një vendimi të tillë mund edhe të ankoheni. I kushtoni vëmendje afateve të përshkruara në letër. Ne lidhje me një të tillë duhet të konsultoni një avokate ose një avokat.



4 Dëgjimi personal

Nëse Gjermania është përgjegjëse për kërkesën tuaj për azil, do te vijë deri tek një seancë dëgjimore pranë organit të zyrës federale.

Ju më pasë do të dëgjoheni në lidhje me arsyet e ikjes tuaj drejtepersedrejt në "Ankunftszentrum" pas parashtrimit të kërkesës. Ose ju do të pranoni me vonë me shkrim një termin për dëgjimin tuaj personal. Në këtë termin ju duhet të paraqiteni patjetër personalisht.

Në qoftë se ju atë ditë jeni i/e sëmurë ose nëse vonoheni, ne ju lutemi të na informoni neve po të njejtën ditë – dhe në rast të sëmundjeve na dërgoni një vërtetim mjeksor (atest) me postë.

Sepse përndryshe kërkesa juaj mund të refuzohet ose të pezullohet procedura juaj.

Përgjat asaj seance dëgjimore ne do të ju pyesim juve në lidhje me arsyet e ikjes suaj nga vendi juaj. Bashkëpunonjësit tanë janë të njoftuar me rrethanat të cilat ekzistojnë në vendin tuaj të origjinës.




Dhe një interprete ose një interpret i gjuhës (përkthyes) i përkthen të gjithat që ju i thuani. Ju e keni të drejtë të sillni me vete edhe një person të besës si përkrahje për ju. Ju nuk keni nevojë të kini frikë dhe njëherit ju ofrohet kohë e mjaftueshme të përshkruani, se për çfarë arsye jeni larguar nga vendi i origjines suaj dhe për çfarë arsye ju nuk mund të ktheheni më atje. E rëndësishme është të na thoni gjithnjë të vërtetën dhe njëherit të raportoni vetëm atë të cilën edhe e keni përjetuar personalisht. Mos i ndëgjoni këshillat e të tjerëve, në qoftë se ato ju propozojnë të raportoni në lidhje me gjëra të cilat nuk i keni përjetuar personalisht. Një e tillë mund të rrezikojë kërkesën tuaj.

Dhe mos harroni ti tregoni të gjithë dokumentacionet të cilat e keni sjellur me vete.



Të gjithat të cilat Ju përgjat seancës dëgjimore nuk i thuani ose nuk i tregoni, eventualisht është e mundshme që më vonë të mos mirren fare në konsideratë pranë zyres federale ose pranë gjykatë.




E gjithë seanca dëgjimore juaj do të inçizohet në një protokol dhe do të ju përkthehet juve sërish gojarisht. Ju keni të drejtë të korigjoni ose plotësoni të njejtin.

Ju atë protokol do ta pranoni të dorzuar menjëher në vazhdim ose të dërguar më vonë me anë te postës.

Në qofte se Ju nuk e kuptoni interpretin e gjuhës (përkthyesin) ose jeni i/e semurë, atëher ju lutemi të na thoni një të tillë në fillim të seancës dëgjimore.

Në qoftë se përshkak të arsyeve tuaja personale do të ishte e patjetërsueshme, dëgjimi i tillë është e mundshme të realizohet nga një person i gjinisë së njejtë. E njejtat vlenë edhe për interpreten dhe interpretin e gjuhës (përkthyesin).

Për seancat dëgjimore të disa grupeve të veçanta kemi bashkëpunonjës të cilët janë të shkolluar në mënyrë speciale. Ato ju qendrojnë në përkrahje viktimave të dhunës përshkak të gjinisë, viktimave të maltretimeve ose të tregtisë me njerëz, njerëzve të traumatizuar dhe femijëve të moshës së mitur të cilët nuk janë të shoqëruar nga prindërit e tyre.




Nëse Ju jeni të prekur, do të ishte më së miri te na thuani të njejtën drejtëpërsëdrejti përgjat parashtrimit të kërkesës suaj.



Në fillim te procedurës së azilit ju do të banoni në një qendër për strehim azilkërkuesish.


Është e mundshme që Ju të mbeteni atje deri sa të vendoset në lidhje me kërkesën tuaj ose të transferoheni në ndonjë qendër tjetër strehimi. Nëse Ju do të ndërroni vendbanimin, atëher ju duhet patjetër të informoni zyren federale, zyrën për te huaj dhe eventualisht gjykatën në lidhje me adresën tuaj të re. Nje e tillë është shumë e rëndësishme, sepse letrat dërgohen gjithnjë në adresën e fundit e cila ju është komunikuar autoriteteve përkatëse.



5 Përfundimi i procedurës së azilit

Në lidhje me vendimin e zyres federale ne do të ju informojmë me shkrimë. Nëse Ju keni një përfaqësues juridik, atëher letra do te ju dërgohet avokates apo avokatit tuaj.

Nëse Ju nuk jeni të pajtimit me vendimin të cilin ka marrur zyra federale, ju gezoni të drejtën ligjore për tu ankuar. Ne lidhje me këtë ju lutemi të keni kujdes afatet e përshkruara në letër. Ju keni mundësin të ankoheni vetëm brenda atyre afateve. Në lidhje me një të tillë ju duhet patjetër të konsultoheni me një avokate apo një avokat.



Vendime negative

Nëse kërkesa juaj është refuzuar si nga ana e zyrës federale për refugjat dhe migracion, njashtu edhe më vonë pranë gjykatë, ju jeni të detyruar të largoheni nga Gjermani deri në terminin i cili ju është përcaktuar me atë rast. Nëse Ju nuk largoheni me vetëdëshirë, atëher Ju edhe mund të dëboheni me dhunë. Një gjë të tillë e vendosin zyret për të huaj. Ju lutemi të shfrytëzoni në kohë të saktë ofertat këshilluese në gjithë shtetin në lidhje me një kthim me vetëdëshirë.

Qendrat këshilluese ju informojnë juve në lidhje me mundësit e kthimit.



Vendime pozitive

Në rast të një vendimi pozitiv, juve do të ju lëshohet nga zyra e juaj për të huaj një leje e qëndrimit.

Se sa do te vlenë një leje e tillë, mvarret krejtësisht nga statusi mbrojtës për Ju dhe mund të ketë një kohëzgjatje në mes një dhe tri vitesh.

Listë kontrolli



1 Mbërritja &
regjistrimi



2 Shtrimi personal
i kërkesës



3 Procedura-
Dublin



4 Dëgjimi
personal



5 Përfundimi i
procedurës së azilit



Dëftues botimi

Botoi:

Bundesamt für Migration und Flüchtlinge
Referat Öffentlichkeitsarbeit, interne Kommunikation
Frankenstraße 210
90461 Nürnberg
E-Mail: info@bamf.bund.de
Internet: www.bamf.de

Burimi:

Publikationsstelle des Bundesamtes für Migration und
Flüchtlinge
www.bamf.de/publikationen

Gjendja:

04/2021

Shtyp:

Silber Druck oHG, 34266 Niestetal

Faqosja:

KonzeptQuartier® GmbH, Fürth

Grafikët:

Materna GmbH, Dortmund

Konzeptimi:

Saliha Kubilay, Referat Öffentlichkeitsarbeit,
Veranstaltungsmanagement, interne Kommunikation

Redaktimi:

Referat Öffentlichkeitsarbeit, Veranstaltungsmanagement,
interne Kommunikation; Abteilung 2, Internationale Aufgaben,
Grundlagen Asylverfahren und Migration

Kjo broshurë është pjesë e punës publike të Entit Federal për Migracion
dhe Refugjatë. Ajo jepet falas dhe nuk është përcaktuar për t'u shitur.



Filmin e broshurës shoqëruese “Informacione për procedurën e azilit”
ju e gjeni nën:
www.bamf.de/asylfilm



OTHER LANGUAGE ?

www.bamf.de/inforefugees